



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr 112-20030

Dt: 14.04.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58. b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, formon Komisionin për verifikimin e respektimit të kontratës së dt. 11.03.2009 për Dhënie-marrjen në shfrytëzim të paluajtshmerisë, ngastra nr. 3350/1 me sipërfaqe prej 0.12 00 hektar për veprimtari tregtare, me dt: 14.04.2016, e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për verifikimin e respektimit të kontratës së dt. 11.03.2009 për Dhënie-marrjen në shfrytëzim të paluajtshmerisë, ngastra nr. 3350/1 me sipërfaqe prej 0.12.00 hektar për veprimtari tregtare e lidhur në mes të Komunës së Gjakovës dhe z. Fehmi Bala, në këtë përbërje:

1. Genc Thaqi, kryesues i Komisionit
2. Pjeter Frrokaj, anëtar
3. Vjollca Shyti, anëtare
4. Ahmet Bajrami, anëtar
5. Agron Gojani, anëtar

2. Komisioni i përkthuar në pikën paraprake duhet të angazhohet për verifikimin e kontratës së dt. 11.03.2009 për Dhënie-marrjen në shfrytëzim të paluajtshmerisë, ngastra nr. 3350/1 me sipërfaqe prej 0.12.00 hektar për veprimtari tregtare. Dhe njëherësh duhet të harton një raport të përgjithshëm për ligjshmërinë e kontratës së lartë cekur deri me dt. 24.04.2016.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Kabinetit të Kryetares së Komunës
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,
Znj. Mimoza Kusari-Lila

7021

Bazuar në Vendimin e Komisionit të Kuvendit Gjakovë mbi dhënjen e palujtshmërive në shfrytëzim 01 nr.011-37/2008, dt.26.12.2008 (nën pika 41), kontraktuasit :

K O N T R A T Ë
mbi bartjen në shfrytëzim të përkohëshem të tokës ndërtimore urbane

E lidhur në Gjakovë, me dt. 11/03/2009, ndërmjet palëve :

1. Komuna e Gjakovës, të cilin e përfaqsonë : Kryetari z.Pal Lekaj (Në tekstin e mëtejme : Dhënsi I palujtshmërisë në shfrytëzim) nga njera anë,
2. Feim Bala nga Gjakova, me nri. 10098213JG (Në tekstin e mëtejme : Shfrytzusi I tokës ndërtimore Urbane, nga ana tjetër.

OBJEKTI I KONTRATËS : Dhënja-marrja në shfrytëzim e palujtshmërisë,ngastra nr.3350/1 (pjesa e sajës),siperfaqe 0.12.00 ha.

I.

Komuna Gjakovë,është pronare - bartëse e së drejtës të shfrytëzimit në palujtshmërinë, e cila sipas Fp.nr.2432, Zk. Gjakovë-Qytet, evidentohet si ngaster kadastrale nr.3350/1, në siperf.të përgjithëshme prej 1.02.60 ha, pjesën e së cilës në siperfaqe prej 0.12.00 ha (1.200 m2), ia bartë në shfrytëzim të përkohëshem, Feim Bala nga Gjakova.

II.

Palujtshmëria e cituar në piken I të kontratës, I bartët në shfrytëzim, shfrytëzuasit Feim Bala nga Gjakova e destinuar për veprimtarinë tregtare(Qender Tregtare),vendosjen e objekteve të karakterit të përkohëshem me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë tregtare.

III.

Kontraktuasit u dakorduan, që palujtshmëria si më lartë, të merret në shfrytëzim të përkohëshem në kohëzgjatje për 10 (dhjet) vite, me të drejtë të ripërtrirjes të kontratës me të njëjtat kushte për shfrytëzim të tokës ndërtimore me afat të caktuar 10+10+10 vite, që rezultonë, shfrytëzimi I palujtshmërisë nga ana e shfrytëzuesit, në kohëzgjatje prej 30 vite, që palet kontraktuse do ta vërtetojnë vazhdimin e kontratës pas 10 viteve, me përpilimin e Anex – kontratë.

Kontraktuasit u dakorduan që me deklarin dhe shprehjen të vullnetit të përbashkët, Kontrata mund të shkëputët duke u shpallur NUL, për qka palët përpilojnë Proqesvërbal të posaqëm i cili konsiderohet pjesë përbërse e kësaj Kontrate. Përfshirje nga parag.paraprakë,dhënsi I tokës në shfrytëzim, Komuna Gjakovë rezervonë të drejten e shkëputjës të njanshme të kontratës, në rastet si vijonë :

- a.) mospërbushja e obligimeve financjare në emer të shfrytëzimit të palujtshmërisë,

01/03/2010, Shënim i obligimeve

b.) mospërbushja e obligimeve financjare në emer të tatimeve të palujtshmërisë të përcaktuara me dispozita Ligjore,
c.) ndrimi i njanshem i qëllimit të shfrytimit të palujtshmërisë, nga ana e shfrytzesit,
d.) shpalla e interesit të përgjithëshem, e imponuar me planet urbanistike të qytetit,
e.) pagesa jo e rregullt e shërbimeve të komunalive, dhe veprimet e tjera që janë kundërshtrim me dispozitat e kësaj kontrate.
Në rast të ndërprerjes të njanshme të kontratës për arsyt e cekur në pikën d.), dhënsi i palujtshmërisë obligohet që shfrytzesit të palujtshmërisë të ja rimbursoi të gjitha shpenzimet investimeve të kryara simbas projektit gjer ne ditën e shkëputjes të kontratës.

IV.

Kontraktuesit u pajtuan që palujtshmëria të bartet tek shfrytzesi me kompenzim duke llogaritur qmimin kushtus për 1.m2 në vlerë prej 1 euro për një (1) muaj, përkatsishtë, shfrytzesi obligohet që dhënsit të palujtshmërisë të ja paguaj shumën mujore prej 1.200 euro (Njimi të dyqind), gjerë për vitin kalenderikë shumën prej 14.400, euro (Katëmbdhjetmijëekaterqind).
Qëraja mujore e përcaktuar nga paragrafi paraprakë fillon të rrjedhë pas kryerjes të investimeve nga ana e shfrytzesit të bazuara në projektin urbanistik, i cili investim verifikohet nga komisioni përkatës i dhënsit të palujtshmërisë.

V.

Palet kontraktuse u pajtuan, që pas skadimit të afatit të përcaktuar në kontratë, investimet e kryara nga ana e shfrytzesit të palujtshmërisë, konsiderohen prone e dhënsit të palujtshmërisë, përkatsishtë investimet simbas projektit të ndërtimit (Qendra Tregtare), konsiderohen asetet e Komunës Gjakovë.

VI.


Për qeshtjet që nuk janë paraparë me këtë kontratë, zbatohen dispozitat e LMD.

VII.

Në rast të konfliktit lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palet do ta zgjidhin me merrrëveshtje dhe mirbesim në të kundërtën kompetent për zgjidhjen është Gjykata Komunalet e Gjakovës.

PALËT KONTRAKTUSE

KOMUNA E GJAKOVËS,



FEIM (Kujtim) BALA

Bala